



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PROGRAMEVE KOMBËTARE

**THIRRJE PËR APLIKIM PËR PROJEKTE TË
INFRASTRUKTURËS SË KËRKIMIT SHKENCOR (PIKSH)
PËR VITIN 2023**

Në zbatim të Ligjit Nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Vendimit Nr.607, datë 31.08.2016 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)” si dhe të VKM Nr. 75 datë 12.08.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, Shkreses se MAS 937/2 date 16.03.2023 “Dergohet detajimi i buxhetit per vitin 2023 per shpenzimet kapitale”, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit shpall thirrjen për aplikim për “Projekte të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë” për vitin 2023.

Institucionet që kanë të drejtë të aplikojnë

Përmes kësaj thirrjeje do të mbështeten financiarisht projekt-propozime nga Institucionet Publike të Arsimit të Lartë Publik që kanë për objekt të veprimtarisë së tyre kërkimin shkencor.

Kritere të përgjithshme për aplikim

1. Projekt-propozimi duhet të vijë nga një Institucion Publik i Arsimit të Lartë (IAL) i akredituar, në përputhje me kërkesat e udhëzuesit përkatës të PIKSH (shiko Udhëzuesin për projektet PIKSH);
2. Projekt-propozimi duhet të përmbajë planin për ngritjen ose rinovimin e infrastrukturës së kërkimit shkencor/laboratoreve të IAL-së, ose planin për blerje të pajisjeve të kërkimit shkencor ku përfshihen, pajisje kryesore ose grupe instrumentesh të kërkimit, koleksione, arkiva ose të dhëna shkencore, sisteme informatike dhe rrjete të komunikimit, si dhe çdo infrastrukturë tjetër kërkimore dhe inovative të një natyre unike, e cila do të shërbejë si për procesin e kërkimit shkencor ashtu edhe atë mësimor në IAL.
3. Projekt-propozimi duhet të përmbajë planin për ta bërë infrastrukturën e kërkimit shkencor të aksesueshme dhe të hapur për përdoruesit e jashtëm¹.

¹ Burimi i referencës: https://ec.europa.eu/info/research-and-innovation/strategy/european-research-infrastructures_en

4. Infrastruktura e kërkuar duhet të plotësojë kriteret e shkencës së hapur, “open science”, sipas përcaktimeve të ESFRI² (European Strategy Forum on Research and Infrastructures) dhe parimeve të Zonës Europiane të Kërkimit ERA³.
5. Projekt-propozimi duhet të mbështetet në prioritetet strategjike sektoriale të miratuara nga Qeveria Shqiptare sipas fushave përkatëse.
6. Projekt-propozimi duhet të argumentojë qartë nevojën për të ndërhyrë në infrastrukturën ekzistuese kërkimore shkencore të IAL-së që e propozon me planin mesimor, kurikulën si dhe planin e kërkimit shkencor të IAL-së.
7. Projekt-propozimi duhet të argumentojë ndikimin që do të ketë infrastruktura e kërkuar në arritjen e objektivave të politikës, strategjisë e misionit të IAL-së;
8. Projekt-propozimi duhet të argumentojë ndikimin dhe avantazhet që infrastruktura e kërkuar do të ketë në zhvillimin e procesit kërkimor shkencor të IAL-së, lidhur me numrin e përfituesve nga projekti, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë (studentë, pedagogë apo komunitet i kërkimit shkencor);
9. Projekt-propozimi duhet të mbështetet mbi një analizë paraprake, të detajuar dhe reale të tregut, për çmimet dhe disponueshmërinë e paisjeve, software, apo materialeve të tjera që synohen të blihen nëpërmjet projektit;
10. Projekt-propozimi duhet të përshkruajë në mënyrë të detajuar planin e mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe të vërtetojë që do ta realizojë atë me burimet e tij financiare dhe njerëzore.
11. Do të kenë përparësi:
 - a) Projekt-propozimet që vijnë në kuadër të mbështetjes së projekteve të studimeve të doktoraturave.
 - b) Projekt-propozimet që kanë siguruar mbështetje financiare nga burime të tjera siç janë: burime të vetë IAL-së; IAL-ve partnere, biznesit, donatoreve etj.

Dokumentacioni i kërkuar për aplikim

Aplikantët duhet të dorëzojnë:

1. Projekt-propozimin të hartuar dhe paraqitur **vetëm** sipas formularit standard të aplikimit për PIKSH të (Aneksi 1 i udhëzuesit);
2. Projekt-propozimi dhe dokumentacioni tjetër duhet të dorëzohen në 2 kopje të shtypura dhe 1 kopje në CD, të shoqëruar me shkresë përcjellëse të institucionit punëdhënës;
3. Vendimin e akreditimit të Institucionit Publik i Arsimit të Lartë që aplikon.
4. Miratimin e projektit nga titullaret (rektori, dhe administratori) e Institucionit Publik i Arsimit të Lartë për pjesëmarrje në projekt;
5. CV e Drejtuesit të projektit, i cili duhet të ketë të paktën gradën “Doktor” në fushën përkatëse;
6. Kopje të diplomës së gradës shkencore apo titullit akademik të drejtuesit të projektit;

² <https://www.esfri.eu/forum>

³ https://ec.europa.eu/info/research-and-innovation/strategy/era_en

7. Nëse IAL ka qenë përfitues i fondeve të AKKSHI-së, të paraqesë vetëdeklarimin që ka shlyer të gjitha detyrimet pranë këtij institucioni ose nëse është në proces të paraqesë situatën në të cilën ndodhet projekti;
8. Në rastet kur për projekt-propozimin është siguruar bashkëfinancim (IAL, IAL partnere, biznesi, donatorët etj), IAL aplikuese duhet të sjellë një evidencë lidhur me bashkëfinancimin (psh një marrëveshje bashkëpunimi midis IAL dhe biznesit)

Afati i fundit për aplikim është data: 30.04.2023

Vlera maksimale e financimit të AKKSHI-se: 40,000,000 lekë;

Fondi i vendosur në dispozicion të kësaj thirrjeje: 204,157,916 lekë.

Dorëzimi i aplikimeve

Aplikantët duhet ta dorëzojnë dokumentacionin **përmes postës zyrtare**, në adresën:

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Rruga “Naim Frashëri”, Nr.37, Tiranë, Shqipëri.

Zarfi i dorëzimit të projektit duhet të jetë i mbyllur dhe të mbajë shënimin

“Thirrja 2023 Projektet e Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor” .

Forma e aplikimit dhe dokumente të tjera lidhur me këtë thirrje mund t’i gjeni në faqen zyrtare të AKKSHI, <http://nasri.gov.al>.

Për sqarime më të hollësishme, lidhur me këtë thirrje ose me procedurat e aplikimit, të interesuarit mund të drejtohen pranë Drejtorisë së Programeve Kombëtare në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit ose me e-mail në adresën: gentiana.spahiu@nasri.gov.al;